




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ

Nr. 12-060/09-0049393/24  
No. 12-060/09-0049393/24  
Data: 22.10.2024  
Data: 22.10.2024



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR  
DRAFT- STRATEGJINË PËR ZHVILLIM  
EKONOMIK LOKAL NË KOMUNËN E  
SKENDERAJT 2024-2028**

Tetor 2024

## **PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT- STRATEGJINË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL NË KOMUNËN E SKENDERAJT 2024-2028**

Duke duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Skenderajt Nr.110-385 i datës 03.12.2008 dhe Nenit 6 pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, DZHENIT paraqet njoftimin për:

### **Konsultim publik për Draft- Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028**

1. Me datën 23.10.2023 kryesuesja e grupit punues z. Besarta Meha Ademi, ka mbajtur takimin e parë me anëtarët e grupit dhe kompaninë konsulente. Kompania konsulente ka prezentuar në tërësi projektin në fjalë. Me këtë rast, janë dhënë edhe disa rekomandime nga anëtarët e grupit punues.

Me datën 30.10.2023 Kompania konsulente “Nexia KS SH.P.K.” Prishtinë, ka mbajtur takimin e dytë me anëtarët e grupit. Kompania konsulente ka kërkuar nga grupi punues, furnizimin me informata të Komunes së Skenderajt në qeshtjet perketëse që i përkasin drejtorive. Besarta Meha ka thënë se të dhënat për popullsinë e komunes nuk përrputhen me të dhënat statistikore të regjistrimit 2011 dhe se ka kërkuar që të bëhet nderhyrje në rregullimin e tekstit. Po ashtu tek parneriteti publiko privat iu është kërkuar kompanisë konsulente që të largohet Eko Natyra si proritete meqë është ndermarrje komunale dhe nuk mund të kete parneritet me komunën.

Leonard Kahrmani po ashtu ka terhequr verejtjen që të plotësohen edhe projektet e parapara deri në vitin 2028

2. Me datën 03.11.2023 Kompania konsulente “Nexia KS SH.P.K.” Prishtinë, ka prezentuar të dhënat që i janë dërguar nga anëtarët e grupit punues dhe formën e draftit dokumnetit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028. Hapja e diskutimit është bërë nga përfaqësuesi i kompanisë konsulente Nexia KS SH.P.K.” Prishtinë, Granit Musliu. Kjo kompani fillimisht ka prezentuar proritete të rëndësishme që mund të jenë për një komunë, ndërsa ka terhequr verejtjen se proritetet janë e drejtë dhe

obligim i komunave përkatëse dhe se perfaqësuesit e zgjedhur të drejtorive të ofrojnë infomatat e nevojshme për prioritetet strategjike në lemitë përkatëse. Të gjithë anëtarët e grupit punues kanë marrur zotimet se do i dergojnë me email prioritetet. Me kete rast Kompanisë iu janë dhënë vërejtje nga kryesuesja se dokumenti duhet të jetë në formatin të cilin e ka prezentuar MAPL.

3. Me datën 04.03.2024 organi mbikqyrës, ka mbajtur takimin e fundit me anëtarët e grupit dhe kompaninë konsulente. Kompania konsulente ka prezentuar në tërësi projektin në fjalë. Me këtë rast, janë dhënë edhe disa rekomandime nga anëtarët e grupit punues. Nga Menaxheri i kontratës Rifat Bajraktari janë dhënë vërejtje:

Fonti i shkronjave të fjalës e kryetarit të sinkronizohet me fontin standard të shkronjave

Te profilet profesionale ka sygjeruar që të cekën disa profile me prioritet dhe të lehet hapësirë për hapjen e profileve të reja krahas zhvillimit

Sinjalizmi dhe harta e vendeve turistike veq ekziston, por të jepën udhëzime për pasurimin e kesaj harte me elemente të reja

Përmirësimi shërbimeve shëndetësore me theks të veçantë në subqendrat, vizitat e mjekëve me qenë të rregullta.

Në bujqësi avancimi i përmirësimeve dhe këshillave profesionale në terren

Kompania konsulente “**Nexia KS SH.P.K. Prishtinë**”, në ndërkohë ka bërë ndryshimin në tekstin e **Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028**, sipas rekomandimeve të cilën ia ka dorëzuar grupit punues.














Grupi punues u dakordua që Ky draft- Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028 të dalë në diskutim publik nga data 28.03.2024 kurse diskutimi publik të mbahet në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal nga ora 10:00.

Lista e pjesëmarrësve diskutim publik me qytetarët lidhur me draftin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028

Nr.	Emri dhe mbiemri	Organizata/ Ndermarrja	Vendi	Kontakti	Nenshkrimi
1	Edona Gashi	DZHENIT	Skenderaj	049-731-846	Edona Gashi
2	Sebahate Haseli	DZHENIT	Skenderaj	044-855-260	Sebahate Haseli
3	Vilijam Ramonani	OJG "DRENGEZA"	Skenderaj	049-685-596	Vilijam Ramonani
4	Almanz Babaj	DRITARE OJG	Skenderaj	04751049	Almanz Babaj
5	Djefra Ahmeti		Skenderaj	049-578-805	Djefra Ahmeti
6	Fikrete Lushtaku		Skenderaj	049-135-199	Fikrete Lushtaku
7	BASRI ZENELI	K.G.DRENICA	SKENDERAJ	07025168	BASRI ZENELI
8	SARIQON KOLWI	K.G.DRENICA	SKENDERAJ	040215024	SARIQON KOLWI
9	Maniam Rexha	B.L.NALIM	SKENDERAJ	044612668	Maniam Rexha
10	LIRIJE VELIJA	DPZ "LIRIJA"	SKENDERAJ	049-391-714	LIRIJE VELIJA
11	Fahrije Shala	Pasteni	SKENDERAJ	045-567-897	Fahrije Shala
12	Arinda Qasfu		SKENDERAJ	046-117-039	Arinda Qasfu
13	LEONARDO KAHRIJANI	G.P.	SKENDERAJ	044/374/038	LEONARDO KAHRIJANI
14	Enmira Hyseni		Skenderaj	043-567-604	Enmira Hyseni
15	Bleona Xhemajli		Skenderaj	044-862-254	Bleona Xhemajli
16	Ermeta Xhimovci		Skenderaj	043-832-980	Ermeta Xhimovci
17	Alberina Gashi	DZHENIT	Skenderaj	043-866-606	Alberina Gashi
18	Shqiponja Rama	DZHENIT	Skenderaj	043-862-907	Shqiponja Rama
19	Vilijam Lushtaku	DZHENIT	Skenderaj	043-892-072	Vilijam Lushtaku
20	Albina Kurbiti	DZHENIT	SKENDERAJ	042-664-732	Albina Kurbiti
21	Drigjet Dajmaku	DZHENIT	Skenderaj	048-906-580	Drigjet Dajmaku
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					

Data: 04.03.2024

### Grupi punues

1	Besarta Meha Ademi	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik-Kryesuese	
2	Jeton Osmani	Zyra e Kryetarit-Anëtar	
3	Getoarba Prokshaj	Drejtoria e Inspektionit-Anëtare	
4	Armend Musliu	DSHMS-Anëtar	
5	Besnik Zabeli	Drejtoria e Administrates-Anëtar	
6	Faton Zeka	DKRS-Anëtar	
7	Arben Zabeli	Drejtoria e Arsimit-Anëtar	
8	Leonard Kahrmani	Drejtoria për Buxhet e Financa-Anëtar	
9	Valentina Jashari	Drejtoria e Urbanizimit-Anëtar	
10	Ismet Gjinovci	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë-Anëtar	
11	Agnesa Rama	Drejtoria e Bujqësisë-anëtare	
12	Sokol Hoxha	Drejtoria e Sherbimeve Publike-anëtar	
13	Amir Lushtaku	Zyra e Informimit-anëtar	

Me 22.02.2024, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft- **Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028**. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike

Drafti u publikua në këtë link në faqen zyrtare:

<https://kk.rks-gov.net/skenderaj/wp->

Në Platformën e Konsultimeve Publike:

Publikimi në faqen e komunës në facebook:

[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=pfbid0NSH7s9YuYKzn1bQfxTYj4JMYCvdtSacsJhp9vZYRhNj6eb64kkST2wRSPmCuu4r1l&id=100064361785032&mibextid=Nif5oz](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid0NSH7s9YuYKzn1bQfxTYj4JMYCvdtSacsJhp9vZYRhNj6eb64kkST2wRSPmCuu4r1l&id=100064361785032&mibextid=Nif5oz)

### KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 04.03.2024 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë të ndryshëm.

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:  
[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=pfbid0Vb4LKePqed7trvUhAMYjabf9kUS4kosfxBGi1S37qkrcn8sVjF8e7yfAXdxtFgUkl&id=100064361785032&mibextid=Nif5oz](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid0Vb4LKePqed7trvUhAMYjabf9kUS4kosfxBGi1S37qkrcn8sVjF8e7yfAXdxtFgUkl&id=100064361785032&mibextid=Nif5oz)

Konsultimi publik filloi në orën 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimin e shpalli të hapur udhëheqësi i grupit punues Besarta Meha Ademi i cili në pika të shkurtëra prezantoi përmbajtjen e Draft Strategjia për Zhvillim Ekonomik, i cili ka për qëllim t'i ofroj priritetet me të rëndësishme të komunes për zhvillimin e gjithëmbarrshëm ekonomik, duke përfshirë informimin e shpejtë, të dhëna të qasëshme, publikimin e të gjitha pririteve dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

**Besarta Meha Ademi, kryesues i komisionit:** Përhëndetje të gjithë, faleminderit që jeni në këtë diskutim publik lidhur me Draft- **Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028**. Komisioni i themeluar për hartimin e këtij plani, ka mbajtur takime para këtij diskutimi, dhe është prezantuar ky dokument në formën e draftit, i cili përmban veprime konkrete, objektiva dhe masa, në funksion të përmirësimit të infrastruktures dhe jetës së qytetarëve. Si dokument përfshin periudhën 5 vjeçare. Pasi të përfundojnë të gjitha procedurat e parapara me udhëzimin për standardet minimale të konsultimeve publike, drafti do të shkojë edhe në Asamble, i cili sapo ta miratojë, do të përcillet edhe në MAPL për shqyrtim përfundimtar.

### **Rritja e shërbimeve komunale**

Zgjerimi i fushës dhe cilësisë së shërbimeve komunale mund të jetë një nxitës i rëndësishëm i të ardhurave. Skenderaj mund të konsiderojë futjen e shërbimeve të reja ose përmirësimin e atyre ekzistuese, si menaxhimi i mbeturinave, parkingjet komunale, apo tarifat e licencimit. Duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke siguruar efikasitetin e tyre, komuna mund të mbledhë të ardhura shtesë duke përmirësuar njëkohësisht cilësinë e jetës për banorët e saj.

### **Kapitalizimi i aseteve**

Teprica e zhvillimit dhe rritjes së infrastrukturës paraqet një mundësi për të kapitalizuar asetet komunale. Komuna mund të marrë në konsideratë dhënie me qira ose në shfrytëzim të pronave të papërdorura ose të pashfrytëzuara, të tilla si toka ose ndërtesa, për zhvillim komercial ose

rezidencial. Duke bashkëpunuar me organizata ose investitorë privatë, Skenderaj mund të zhbllokojë potencialin latent të këtyre asetëve, duke gjeneruar të ardhura të konsiderueshme. Kjo qasje jo vetëm që sjell fonde shtesë, por gjithashtu stimulon aktivitetin ekonomik, duke krijuar vende pune dhe duke përmirësuar peizazhin urban. Ndonëse prezentimin e draftit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik është bërë nga kompania punuese Nexia KS sh.p.k. Prishtinë, si pika kyçe në zhvillimin ekonomik janë Deversifikimi i Zhvillimit Ekonomik, Zhvillimi i Turizmit, Angazhimi i të rinjëve dhe sipërmarrësve, bujqësia, zhvillimi rural, ikrëqenia Sociale, Zhvillimi i Kultures Rinisë dhe Sportit, Administrata Shërbimet Publike, Planifikimi Urban dhe Mbrojtja e Mjedisit, Gjeodezia dhe Digjitalizimi i Kadastrit, Implementimi i Strategjisë. Në këtë diskutim të prishmit përpos që janë njoftuar me draft strategjinë, ata kanë parashtruar edhe pyetje dhe kanë dhënë komentet e tyre.

Në takim janë dhënë disa vërejtje:

- Fonti i shkronjave të fjalës kryetare të sinkronizohet me fontin standard të shkronjave
- Të profilet profesionale të sygjeruar që të cekën disa profile me prioritet dhe të lehtë hapësirë për hapjen e profileve të reja krahas zhvillimit
- Sinjalizimi dhe harta e vendeve turistike veq ekziston, por të jepën udhëzime për pasurimin e kesaj harte me elemente të reja
- Përmirësimi shërbimeve shëndetësore me theks të veçantë në subqendrat, vizitat e mjekëve me qenë të rregullta.
- Në bujqësi avancimi i përmirësimeve dhe këshillave profesionale në teren.

Konsultimi përfundoi në orën: 10:40

**Në mbledhjen e asamblesë komunale me 28.03.2024** repektivisht pika e shqyrtimit të draftit të dokumentit të Strategjisë Zhvillimore Lokale 2024-2028 fillimisht;

**Kyesuesja e grupit Besarta Meha Ademi** ka bërë prezentimin të draftit të strategjisë, duke i përmendur të gjitha fushat e seciles drejtori, me theks të veçantë. Në ndërkohë janë ftuar të pranishmit për diskutime.

**Hysni Mehani nga subjekti politik i VV**

- Ka dhënë vërejtje se ky dokument ka elemente të kopjimit nga wikipedia.
- Në të dhënat e bizneseve ka shprehur shqetsimin për saktësinë e tyre.

- Po ashtu në faqe 12 teksti; nuk ka ndonjë rrezik nga vershimet falë pozites së favorshme. Kjo nuk qendron sipas asambelistit ngase në vitin 2023 kishim vershime të medha
- Divesifikimi i zhvillimit ekonomik dhe mirëqenia sociale janë pa ndonjë kutim sipas asambleistit Mehana.

**Afrim Kabashi nga subjekti politik i Nisma** ka dhënë verejtje se teksti nuk është i sinkronizuar si dhut dhe nuk ka kuptim, sidomos ne lemin e bujqësisë.

**Në fund asambleja me** 16 vota për, 10 kunder, asnjë abstenim, ka miratuar draft dokumentin e **Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028.**

Dokumenti i miratuar nga Asambleja Komunale është derguar për shqyrtim në MAPL me datën 04.04.2024. Me datën 13.05.2024 nga MAPL është refuzuar dokumenti, me asyetimin se dokumenti nuk është në përputhje me udhezuesin e publikuar nga MAPL. Verejtjet po ashtu kanë qenë rreth objektivave.

Grupi punues në konsultim me Kompaninë konsulente “Nexia KS SH.P.K.” Prishtinë” ka marrë k për bazë verejtjet dhe rekomandimet nga MAPL-së, ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe me datën 07.06.2024 draft dokumneti është miratuar edhe nga asambleja komunale qe i njeiti është derguar në MAPL për rishqyrtim me datën 14.06.2024.

Me datën 15.08.2024 nga MAPL është kthyer vendimi perfundimtar, sipas te cilit draft dokumenti i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal në Komunën e Skenderajt 2024-2028 përmbushë kriteret në tërësi sipas udhëzuesit të publikuar nga kjo ministri dhe se i njeiti mund të shfrytëzohet nga Komuna e Skenderajt për zbatim.

Rifat Bajraktari  
  
Menaxher i kontrates

